



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Belsh më 29/ 08 / 2025

PROCES - VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 29.08.2025”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 12 këshilltarë:**

1. Enkeleda Kullolli
2. Erion Gjoshi
3. Erjon Qafa
4. Bujar Blloku
5. Nexhip Elezi
6. Naime Ibrahim
7. Gezim Gjoshi
8. Aleksander Idrizi
9. Gazeli Hysa
10. Ismail Paja
11. Nertila Uruçi
12. Kujtim Dervishi

- Hapet mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari i këshillit. Hidhet në votim rendi ditës dhe miratohet me 12 vota pro. Kalojmë te pika nr.1.
- Mbron Anxhelina Liçi dhe prezanton projekt vendimin.
- N.Uruçi: Cilët janë efektet financiare?
- A.Liçi : 50 % mbulohet nga Këshilli I Ministrave dhe 50 % nga Bashkia Belsh.
- A.Nipolli: Roli kryesor i akademisë është trajnimi i punonjësve.
- N.Uruçi: Është një hap shumë i mirë që të realizohet akademia, dhe të realizohen trajnime për punonjësit.
- Kujtim Dervishi: Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 11 vota pro dhe abstenon G.Hysa.
- Kalojmë te pika nr.2 e rendit të ditës, “Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025”.

- Prezanton projektin Alban Nipolli.
- N.Uruçi : Pse ndodh ndryshimi?
- A.Nipolli : Është vetëm transferim fondi sipas planifikimit në fillim të vitit.
- Hidhet në votim projekt vendimi dhe nuk miratohet me 10 vota pro dhe 2 abstenime. Abstenon I.Paja dhe G.Hysa.
- Kalojmë te pika nr. 3 e rendit të ditës : “P/Vendim për miratimin e programit buxhetor 2026-2028,Faza II”. Prezanton Alban Nipolli.
- I.Paja: Çfarë kemi planifikuar për të pastrehët?
- A.Nipolli: Nga ana financiare sot Bashkia e ka të pamundur të bëjë një investim në këtë fushë.
- I.Paja: A jeni drejtuar ministrisë?
- A.Nipolli: Po i jemi drejtuar ministrisë.
- K.Dervishi: Si bashki rurale është e vështirë të ketë investime në këtë fushë.
- E.Gjoshi: Cili është drejtimi i zhvillimit ekonomik?
- A.Nipolli: Turizmi është vizioni që duhet ndjekur për zhvillimin ekonomik.
- B.Blloku: Bashkia Belsh nuk mbahet me turizëm.
- N.Uruçi : Për mbledhjen e ardhshme më sillni një informacion se cilët rrugë kanë përfunduar.
- K.Dërvishi : Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 11 vota pro dhe 1 kundër.
- Nexhip Elezi: Kemi problem me mbetjet dhe tërheqjen e tyre.
- I.Paja : Kërkojmë që personi përgjegjës për mbetjet të vijë mbledhjen e ardhshme.
- N.Uruçi: Kërkojmë vendosjen e 2 policave të shtrira në qendër të Belshit.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA

